



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverballi i mbajtur më 31 tetor 2016, në mbledhjen e XXXIV-të (tridhjetekatër) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10:10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit, përveç z.Xhevdet Beselica i cili mungoi.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe, z.Nexhmi Rudari Nënkryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, përfaqësuesi i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

E pranishme në sallë ishte edhe znj.Donjetë Sheqiri, kryetare e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal - Podujevë.

1. Miratimi i rendit të ditës

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, ndër të tjera theksoi, konsideroj se thirrja dhe materiali për këtë mbledhje ju është dërguar me kohë, gjithashtu ju njoftoj se në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa është diskutuar për këto pika të rendit të ditës të cilat i janë rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Nëse nuk ka këshilltarë të lajmëruar për të marrë fjalën, unë e hedh në votim rendin e propozuar të ditës.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës.

2. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – shtator 2016

Kryesues i Kuvendit, ftoj drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave të paraqesë një fjalë hyrëse rreth këtij raporti.

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave (DBF), e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij raporti, ndër të tjera theksoi, qëllimi i këtij raporti si obligim ligjor, është prezantimi i pasqyrave financiare të zhvilluara për periudhën përkatëse në Komunën e Podujevës, shpenzime të cilat janë bërë të ndara sipas kategorive ekonomike dhe burimeve të financimit si dhe duke bërë krahasim me të gjitha llojet e shpenzimeve në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në vazhdim drejtori lexon shumat dhe përqindjet e shpenzuara në programe dhe kategori të caktuara buxhetore, ceket edhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit paraprak që del se ka një zvogëlim të shpenzimeve prej 7.68% i reflektuar si tërësi të investimet kapitale.

Sa i përket planifikimit dhe realizimit të të hyrave vatanake të Komunës për këtë periudhë, drejtori veçon shumën e inksaimit prej 1,197,216.00 € ose 70% e planit vjetor e që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak vërehet rritje rreth 41%, përqindje në të cilën nuk janë llogaritur të hyrat nga donatorë të jashtëm prej 107,283.00 €. Si inkasim inkurajues drejtori e cilëson të hyrat nga tatimi në pronë në shumë 503,342.00 € ose 135% e planit vjetor, dhe shton, nga hyrja në fuqi e ligjit për faljen e borxheve deri më 02.10.2016, të drejtën ligjore e kanë shfrytëzuar 2422 tatimpagues ku borxhi total i tyre ka qenë 1,159,000.63 €, janë paguar 353,367.93 €, ndërsa shuma e falur sipas ligjit është 1,245,696.00 €, por edhe përkundër kësaj mbetet shumë për tu bërë që deri në fund të vitit ta përmbyllim suksesshëm këtë vite buxhetore si në shpenzim të buxheti ashtu edhe në të hyra vetanake. Në fund drejtori potencoj, mund të konstatojmë se ky raport financiar jep një pasqyrë të qartë të të gjitha të hyrave dhe të dalave të Komunës për këtë periudhë nëntëmuajore të vitit 2016.

z.Fidan Rekalio, theksoi, në Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim këtë raport financiar të Komunës së Podujevës për periudhën janar – shtator 2016, raport i cili paraqet të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e Komunës për periudhën përkatëse.

Vlen të përsëritet përkushtimi i madh i drejtorit të DBF i cili vite me radhë ka bërë një praktikë të mirë të paraqitjes së raporteve financiare periodike të rregullta në Kuvendin e Komunës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk kemi diskutuar gjatë për këtë raport për shkak se mos prezenca e znj.Mrika Thaqi, drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit na bëri të kalojmë në një fushë tjetër përkatësisht për dy propozimet e kësaj Drejtorie, mirëpo për raportin financiar kemi rekomanduar që në këtë mbledhje të Kuvendit të diskutohet më gjerësisht. Mendoj se Kuvendi i Komunës është ai i cili i legjitimon shpenzimet e Ekzekutivit të Komunës. Është e vërtetë se raportet financiare sjellën në Kuvend si dokumente, mirëpo sa arsyetohen punët dhe shpenzimet nga ana e Ekzekutivit për këto projekte është çështje tjetër e cila mbetet e Kuvendit që dokumentet e tilla t'i vlerësoj pozitivisht ose negativisht. Të gjithë jemi në dijeni se në këtë vit buxheti i Komunës për investime dhe projekte të ndryshme kapitale është mbi 5 milion euro të cilat do të shkonin në interes të qytetarëve të Komunës së Podujevës. Gjithëherë kemi pas kërkesë që projektet e Drejtorive të bëhen në koordinim me Komitetin për Politikë dhe Financa, gjë e cila nuk ka ndodhur deri tani dhe mendoj se kjo tregon paaftësinë ose neglizhencën e Drejtorive sepse tani kur jemi në përfundim të këtij viti fiskal afro 3.5 milion euro nuk janë shpenzuar ende. Unë nuk do të dëshiroja që këto mjete të Komunës së Podujevës të kalojnë në suficid buxhetor sikurse që ndodh në disa komuna tjera. Përshtypje më kanë bërë dy dikastere shumë të rëndësishme që janë, shëndetësia dhe arsimi, për të cilat deri tani për nëntë muaj janë paraparë vetëm rreth 100,000.00 € përkatësisht rreth 20,000.00 € për arsim, dhe rreth 80,000.00 € për shëndetësi. Gjithashtu në këtë raport ka investime të parëndësishme, shembull, vetëm për telefoni dhe për mirëmbajtje të veturave shuma e shpenzuar është afërsisht sa krejt buxheti për dy dikasteret e lartpërmendura, andaj mendoj se këto shpenzime janë të paarsyeshme ku rreth 12,000.00 € vetëm për telefoni mobile është shumë e tejkualuar dhe për të cilat nuk mendoj se janë shpenzuar të gjitha për punë zyrtare, mirëpo nëse nuk ka komunikim të mirëfilltë mes drejtorëve të Drejtorive dhe Kryetarit të Komunës është çështje tjetër, gjë e cila është thënë edhe në raportet e auditorit të përgjithshëm. Çështja tjetër është, pagesat për vendime të Gjykatave, e cila përcillet në çdo raport financiar të Komunës të cilat bëhen sipas neni 39.2 të ligjit për financat publike ku shuma arrin 7,029.00 €, mendoj se ato pagesa është dashur të kryhen me kohë mirëpo tatimet që janë ngritur me ligjin e ri ashtu siç i japin bankat komerciale 8 %, e që ka qenë 2.5 % deri në 3 %, dhe tani kur të përpjesëtohen këto pagesa të vendimeve i bie rreth 40,000.00 €, andaj për këtë çështje drejtori i DBF mund të kalkulon

më së miri se sa mjete buxhetore është dashur të paguhen më shumë si shkak i kësaj rritjeje. Pastaj kemi pagesa për punëtorë me kontratë mbi vepër, gjë për të cilën në një mbledhje të mëhershme drejtori i Drejtorisë së Administratës e ka thënë se numri i punëtorëve me kontratë mbi vepër është 13, punëtor të cilët janë të angazhuar nëpër Drejtori të caktuara dhe të cilët paguhen nga të hyrat vetanake, sepse nuk janë në listën e pagave në mënyrë që pagesa t'iu bëhej nga niveli qendrorë, mirëpo unë mendoj se edhe nëse ata punëtorë janë të angazhuar politikisht nga subjekti LDK, qoftë persona tjerë me angazhime të ndryshme dhe nëse kanë aq shumë nevojë për punë dhe nëse të njëjtit janë aq të rëndësishëm që projektet të ecin përpara, t'iu hapet vendi i punës dhe të paguhen zyrtarisht e jo të mbahen me kontrata mbi vepër me vite të tëra. Sa i përket investimeve, konkretisht te pagesat e rrugëve dhe shërbimeve publike, në raport është një pagesë mbi gjysmë milioni euro, unë kam pyetje konkrete për këtë çështje sepse ky raport sot do të votohet dhe se drejtorët e Drejtorive gjithëherë arsyetohen se jemi në fund të realizimit të disa kontratave dhe pagesat duhet të bëhen deri në fund të muajit dhjetor, gjë për të cilën mendoj se është shumë e natyrshme ajo që ka projekte në vazhdimësi dhe nuk kanë mund të bëhen pagesat, mirëpo kërkoj që secila Drejtori veç e veç, ashtu siç i ka sjellë pagesat në këtë raport, tani të na tregoj konkretisht, cilat projekte janë në vazhdimësi, konkretisht me emër cilat janë rrugët që janë shtruar duke cekur në cilin vend qytet – fshat, për arsye se mendoj se në këtë seancë është mirë të detajohemi se ku janë kryer ato investime. Po ashtu kemi vërejtur edhe një pagesë mbi 7,000.00 € kompanisë "Bini", për rregullim të ambienteve të varrezave, ne realisht nuk jemi kundër këtyre pagesave për shërbime të tilla, mirëpo të gjithë jemi dëshmitarë të ceremonive të varrimeve ku asnjëherë nuk kemi parë se është bërë ndonjë mirëmbajtje apo investim në varrezat e qytetit, andaj është mirë që konkretisht dhe specifikisht të njoftohemi ne si Kuvend nga të gjithë drejtorët e Drejtorive për investimet emër për emër të cilat janë përfunduar dhe ato në proces të përfundimit. Vlen të ceket se Drejtorja e Arsimit dhe Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale qëndrojnë shumë keq me buxhet dhe mendoj se është mirë që të rritet buxheti vjetor i këtyre dy Drejtorive në mënyrë që të ngritet niveli i shëndetësisë dhe arsimit, realisht kemi parasysh buxhetin e ndarë për këto dy kategori nga niveli qendrorë mirëpo si Komunë kemi mbi 1 milion euro të hyra vetanake dhe një pjesë të tyre mund ta destinojmë për investime në arsim dhe shëndetësi. Po ashtu vlen të ceket edhe problemi që është aktualizuar tash së fundmi rreth objektit të shkollës së re "Enver Maloku", unë personalisht dy herë kam vizituar çështjen e transportit të nxënësve të asaj shkolle që është duke ndodhur në shkollën e fshatit Letancë ku në bazë të kontakteve me nxënës dhe me qytetarë tjerë, për këtë bartje janë të angazhuar vetëm katër autobus, pagesa për këtë bartje i bëhet kompanisë përkatëse, por jemi njoftuar se nxënësit kanë probleme sepse disa nxënës udhëtojnë, po ashtu sipas trupit arsimor dhe nxënësve orët e fundit nuk janë mbajtur asnjëherë, çështje për të cilën nuk jam në dijeni se Grupi i këshilltarëve të LDK –së a është marrë me ndonjë prej këtyre probleme dhe a është interesuar rreth transportit të atyre nxënësve të SHFMU "Enver Maloku" në shkollën e fshatit Letancë deri sa të përfundon objekti i ri përkatës. Mendoj se ne jemi të votuar nga qytetarët dhe duhet të punojmë ashtu siç na kanë besuar qytetarët votën e tyre konkretisht duhet të punojmë në interes të qytetarëve. Sa i përket pagesave dhe shpenzimeve të ndryshme ne gjatë këtij debati do t'i dëgjojmë edhe arsyetimet e drejtorëve të Drejtorive dhe do të shohim se si qëndrojnë ato, mirëpo sinqerisht i drejtohem drejtorit të DBF z.Isuf Latifit, në raport figurojnë rreth 12,000.00 € shpenzime për telefoni me një ngritje prej 102% në krahasim me vitin e kaluar, ndërsa në anën tjetër Kryesuesi i Kuvendit ankohet se nuk ka as të vetmen 5 € në muajt për të kontaktuar me Grupet e këshilltarëve të Kuvendit si dhe nuk ka Kuvendi buxhet për çështje operative në funksion të kryerjes së punëve të Kuvendit dhe kërkoj të na shpjegojmë shumën e shpenzuar prej 12,000.00€

për telefoni mobile dhe fikse, në cilën Drejtori apo në emër të kujt janë bërë ato shpenzime dhe në emër të kujt është pagur ai shpenzim, unë personalisht e kam kalkuluar dhe del se në rast se drejtorët e Drejtorive për një muaj nuk qëndrojnë fare në zyrë dhe nonstop për katër orë flasin në telefon, nuk do të krijohej shuma e shpenzimeve përkatëse telefonike. Pra e përsëris, kërkoj të jepet një përgjigje për shumën e shpenzuar për telefoni mobile dhe fikse, në emër të cilit drejtor ose Drejtori, në mënyrë që konkretisht ta dimë se sa punohet punë zyrtare konkrete me këto.

z.Bahri Selimi, theksoi, edhe Grupi i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje e ka shqyrtuar dhe analizuar raportin financiar përkatës të Komunës së Podujevës që është edhe obligim ligjor për sjelljen e tij në Kuvend dhe gjatë analizës kemi nxjerrë disa mangësi ose të meta që janë në këtë raport. Drejtori i DBF në fjalën hyrëse i potencoj shpenzimet me shuma sipas kategorive paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe shpenzime kapitale, kategori të cilat unë do t'i paraqesë me shifra duke nxjerrë edhe përqindjet me qëllim që të shohim sa pak dhe dobët është menaxhuar buxheti i Komunës në këtë nëntëmujorë. Nga buxheti total i Komunës del se 61.3% është i shfrytëzuar, atëherë në kategorinë shpenzime kapitale e cila është më e ndjeshme dhe më e nevojshme për qytetarët e Komunës së Podujevës, nga 5,010,953.00 € janë shpenzuar vetëm 1,541,480.00 € që në përqindje i bie 30.9% e shumës së përgjithshme. Nuk e di se a mund të themi se është bërë një menaxhim i drejtë dhe i mirë apo jeni menaxher të mirë të Komunës, përderisa shpenzimet në këtë kategori në nëntëmujorin e parë të vitit, e që konstant për këtë periudhë do të duhej të ishte mbi 75%, ndërsa janë vetë 30.9%. Kur e shikojmë këtë shpenzim na shkojnë për mendje shumë arsye ku një prej tyre është, a thua ne si qytet aq mirë i paskemi punët që mos të kemi ku ta shpenzojmë buxhetin kurse nga ana tjetër përgjigje e kësaj pyetje është se Komuna e Podujevës renditet ndër Komunitat më të varfra të Kosovës dhe nëse është kjo që e thash, si ka mundësi që të mos kemi ku t'i shpenzojmë mbi 5 milion euro, përderisa kërkesat e qytetarëve që vijnë me adresa të ndryshme për nevojat e shumta që kanë dhe që Komuna ose Ekzekutivi jonë nuk i përmbush ato kërkesa. Gjëja tjetër që na shkon për mendje është ruajtja kaq e madhe e këtij buxheti, a mos vallë ndokujt po nevojitet për fund vit që ndoshta ka paramenduar që këtë buxhet ta arsyetoj apo ta shfrytëzoj në mënyrat e veta ashtu siç dinë pushteti ta bëjë lojëra të ndryshme për t'i arritur disa qëllime të veta. Kategoria tjetër për të cilën sërish mendojmë se nuk është bërë një menaxhim i mirë është ajo e subvencioneve ku nga 568,883.00 € të parapara dhe të miratuar në këtë Kuvend, janë shpenzuar 249,864.00 € apo 43.9% të buxhetit, pra në nëntëmujorin e parë janë investuar vetëm 43.9% e buxhetit për subvencione e që edhe për këtë në konstant të kohës mendojmë se do të duhej të ishte mbi 75% e këtij buxheti e shfrytëzuar në subvencione, mirëpo si është paraparë që këto subvencione të shfrytëzohen në tremujorin e fundit, sërish po e them se më së miri e dinë qeverisja e cila edhe këtu mendoj se ndokujt i ka mbetur borxh dhe duhet që në fund vit t'ia kthej borxhin. Hiq mirë nuk qëndron gjendja edhe te kategoria mallra dhe shërbime, a nuk do të duhej që edhe në këtë kategori në konstant të kohës të shfrytëzohej mbi 75% e buxhetit përderisa janë shpenzuara vetëm 55%, gjë për të cilën mendoj se përgjigjen duhet të na e jap drejtori sepse është një kategori ku po thajse shpenzimet janë gjithherë të njëjta.

Përshtypje tjetër që na bënë në këtë raport janë edhe të hyrat vetanake ku rreth 70,000.00 € nga të hyrat janë shpenzuar për paga në arsim, dhe 40,000.00 € tjera për paga në shëndetësi, kurse sa jemi në dijeni dhe të njoftuar ne, këto pagesa rregullohen me grant qeveritar, dhe nuk e di a është e nevojshme që rreth 119,000.00 € nga të hyrat vetanake të kryhen pagesa për paga, a do të ishte më mirë që këto pagesa apo të hyra vetanake t'i ktheheshin qytetarëve në formën çfarë i marrim prej tyre, pra ato janë tatime që qytetarët në një formë i servojnë në buxhetin e Komunës

në mënyrë që ato t'iu kthehen atyre në interesa të përgjithshme e jo kështu për interesa të veçanta që unë i quaj, nga paga është interes i veçantë i një personi ose punëtori.

Nëse mendojmë se me këto mjete janë paguar punëtorët me kontratë mbi vepër, e që unë mendoj se Komuna ka nevojë shumë për angazhim të ekspertëve të ndryshme në mënyrë që të përfitoj apo nxjerrë diçka prej tyre, këtu prap nuk përputhen shifrat sepse në bazë të raportit – kodi 11400 del se për punë me kontratë të tillë janë paguar 10,169.00 €, por edhe nëse e kalkulojmë me shifrën e 12-13 punëtorëve që paguhen prej grantit qeveritar, gjë e cila është thënë në një raport të mëhershëm të Komunës, i bie që ata punëtorë ta kenë një pagë bukur të lartë, për të arritur shumën prej 119,000.00 €, pothuajse barabartë me një Ministër ose Deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, prandaj edhe për këtë kërkojmë sqarime nga drejtori sepse kjo shumë e shpenzuar e mjeteve nga të hyrat vetanake është e lartë për paga dhe mëditje. Gjëja tjetër që në vazhdimisht na përsëritet në raporte të tilla, është edhe tek kompanitë fituese të tenderëve, gjë për të cilën unë personalisht në këtë Kuvend gjatë shqyrtimit të raportit të fundit e kam cekur se në Komunën e Podujevës sikur gjithherë fituese po janë kompanitë e njëjta, dhe përgjigjja na është dhënë se gjithherë fituese janë kompanitë më të mira dhe më të lira, mirëpo e përsërisë se si ka mundësi që një kompani e njëjtë, shembull, për ndërtimin e një kanalizimi në ndonjë fshat të jetë gjithherë e njëjta kompani, edhe më e mira edhe më e lira, por unë këtu mendoj se këto kompani janë të përkëdhelura nga dikush brenda këtu dhe për këto arsye ato i fitojnë tenderët sa herë që konkurrojnë. A jeni në dijeni se në këtë nëntëmujorë sipas këtij raporti një kompanie i është bërë pagesë 18 herë përderisa ka kompani të cilat nuk mund t'i ofrohen as derës së Komunës, pastaj ka edhe kompani që 11 herë i është bërë pagesë. Sa është duke u punuar drejtë dhe transparent me dhënien e tenderëve kompanive të ndryshme edhe për këtë më së miri e dinë Ekzekutivi i Komunës dhe Kryetari i Komunës të cilët po i favorizojnë kompanitë për ndërtimin e rrugëve apo kanalizimeve, e që kualiteti i tyre shihet shumë mirë dhe qartë sa herë që dalim në rrugë ku një reshje e shiut sa do i vogël të jetë, asfalti i qytetit të Podujevës vërshohet, ndërsa ka rrugë që pas një ose dy muajve asfaltim cilësia e tyre ka rënë në zero dhe janë tërësisht të dëmtuara. Për shqetësimet që ne i ngritëm sot, besoj se të paktën ta kemi një përgjigje nga drejtorët e Drejtorive dhe të vazhdojmë t'i shqyrtojmë edhe në vazhdim të kësaj seance.

z.Faik Muqiçi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit (DSHPMSH), theksoi, ky raport nëntëmujor është raport real i shpenzimeve, mirëpo raportet e shpenzimeve nuk janë reale me dinamikën e projekteve gjë për të cilën besoj se të gjithë janë në dijeni ngase ka projekte që ndër kohë ose kanë qenë duke u punuar ose kanë qenë në procedurën e prokurimit ose në fazën finale të nënshkrimit të kontratave etj. Megjithatë në DSHPMSH nga 1,285,142.00 € që kanë qenë grant qeveritar, të gjitha projektet e parapara dhe të miratuara në këtë Kuvend janë proceduar me kohë në prokurim, përveç investimeve kapitale për raste emergjente që besoj se asnjëri prej neve këtu nuk dëshiron të ketë një projekt të tillë, të gjitha të tjerat janë përfunduar, proceduar ose janë në përfundim të nënshkrimit të kontratave. Në raportin e parafundit financiar thuhet që janë shpenzuar saktë 900,430.00 € e që do të thotë se është larg këtij raporti nëntëmujor sepse vetë dinamika e disa projekteve ka qenë që në fund të muajit shtator ose në fillim të muajit tetor kanë përfunduar ato projekte dhe janë bërë pagesat apo edhe situacione tjera gjatë punimeve, si dhe në kuadër të Drejtorisë kemi disa projekte të cilat janë dy vjeçare të cilat bartin në vete një buxhet bukur të madh siç janë, zgjerime të shtretërve të lumenjve në shumë 83,000.00€ që në dy projekte të ndryshme është duke u punuar dhe sot fillon projekti i tretë me vlerë 53,000.00 € plus në fshatin Lupç, pastaj kemi projektin dy vjeçar për ndërtimin e trotuareve me buxhet rreth 86,000.00 €, mandej projekti për ndriçim publik në shumë 40,000.00 € etj, pra janë projekte të cilat kanë afate pavarësisht kohës që mund të punohet. Shpenzimet janë paraqitur

në secilin situacion të raportit që ju e posedoni, mirëpo jam i gatshëm që për secilin projekt veç e veç t'ju jap sqarime, por kjo do të merrte shumë kohë, por unë i posedoj të gjitha projektet e përfunduara, ato që janë duke u punuar dhe ato që janë para nënshkrimit të kontratave përkatëse e që do të ishte një raport i gjatë po të sqarohen të gjitha këto. Megjithëse sot jemi duke debatuar për një raport financiar sesa për raporte të punimeve, por megjithatë ju them se janë duke u punuar punë në vetëm gjashtë projektet, kurse gjitha të tjerat janë përfunduar, janë në përfundim ose para pranimeve teknike, më gjerësisht, janë përfunduar rreth 2930 metra gjatësi kanalizim dhe kolektorë, disa prej projekteve të përfunduara janë kolektori Gllamnik-Konushec, kanalizimi në fshatin Godishjak që ka qenë projekt dyvjeçarë, kolektori Shtedim-Dumnicë 2940 metra gjatësi, ndërtimi i urave në fshatrat Konushec, Dvorishtë, Pakashticë dhe ura e re në parkun e qytetit, pastaj ka përfunduar faza e parë e ndërtimit të trotuareve me rreth 5000 m², ndërsa tani ka filluar faza e dytë që është projekt dyvjeçarë. Në fazën e punimeve është zgjerimi i lumenjve Lluzhan-Bellopojë, pastaj para pranimet teknik janë projektet e ndërtimit të kanalizimeve në Herticë, Siboc, projekt i përfunduar është edhe kolektori me gjatësi 5 kilometra Batllav-Gërdoc e të tjera, pra është një mori e projekteve të cilat sipas dinamikës shpresoj që do të përfundojnë suksesshëm.

Sa i përket suficitit të buxhetit, tani për tani është herët të themi, por megjithatë në DSHPMSh kemi shumë e mjeteve të ridestinuara prej 96,300.00 € për të cilat këto ditë presim të përfundojnë procedurat përkatëse ku nga ajo shumë e mjeteve rreth 80% janë shpenzime e që do të thotë se ridestinimi në një mënyrë e ngadalëson dinamikën e shpenzimeve. Vlen të ceket se dinamika e realizimit të projekteve nuk varet vetëm nga Drejtoria, por varet edhe nga procedura e prokurimit, vlerësimi i tenderëve, ankesat eventuale, dinamika e punëve, pengesat gjatë punimeve e të tjera, procedura për të cilat besoj se të gjithë jeni në dijeni, mirëpo ne shpresojmë që së pari ta shpenzojmë buxhetin arsyeshëm, e së dyti ta shpenzojmë maksimalisht në mënyrë që të mos kemi suficit, por edhe nëse do të ketë është më mirë sesa të ketë shpenzime të pakryera ose të kryera dobët. Sa i përket pyetjes së këshilltarit z.Rafet Llapashtica rreth varrezave, përgjigja është se ajo kontratë ka qenë dyvjeçare dhe në këtë vit janë përfunduar vetë tri rrugë me zhavorr në fshatrat Dobratin, Lepajë dhe Tërnavë, pra shuma e shpenzuar 7,100.00 € ka qenë një situacion i kontratës dyvjeçare dhe nuk ka pasur procedura të reja sa i përket rregullimit të infrastrukturës së varrezave. Lidhur me atë që parafolësi z.Bahri Selimi e ceku rreth përzgjedhjes së kompanive punë kryese, kjo çështje është totalisht jashtë kompetencave të Drejtorive dhe se ne nuk mund të ndërhyjmë në gjëra të tilla, por janë procedurat e prokurimit që rregullojnë këtë fushë, drejtorëve vetëm iu dorëzohen kontratat dhe menaxherët e projekteve përkatëse, ndërsa drejtorët vetëm i zbatojnë ato. Situacionet bëhen vetëm brenda punimeve dhe për këtë ju garantoj se në DSHPMSh asnjë pagesë dhe asnjë situacion nuk bëhet pa u kryer puna përkatëse dhe për këtë të gjithë menaxherët e kontratave janë në dijeni se më parë do të ketë suficit të buxhetit, sesa që do të ekzekutohen pagesa paraprake apo pagesa për punë që nuk janë përfunduar sipas dinamikës dhe planifikimeve përkatëse.

Për fund, falë kohës së mirë që po merr, por edhe dinamikës së projekteve siç janë ndërtimi i trotuareve, ndriçimi publik ose zgjerimi i shtretërve të lumenjve, shpresojmë që deri në fund të muajit nëntor të përfundojmë arsyeshëm me shpenzim maksimal të buxhetit të planifikuar.

z.Lufti Rexhepi, theksoi, këshilltari z.Fidan Rekalii e përgëzoi drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave për përmbushjen e një obligimi ligjor me rastin e sjelljes së këtij raporti në Kuvendin e Komunës, gjë për të cilën më vie mirë sepse këtu edhe kur përmbushet një obligim ligjor duhet të përgëzohet dikush. Më lejoni që të përgëzoj edhe Kryetarin e Komunës i cili edhe pas tri viteve arriti ta kompletoj Ekzekutivin e vet. Kam pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Administratës z.Fatmir Gashi, dhe atë, punëtorët për shërbime të veçanta të cilët vazhdimisht për çdo vit janë me dhjetëra

në Komunën e Podujevës, do të dëshiroja emrat e tyre se kush janë, profesionet e tyre për shërbimet e të cilëve ka nevojë Komuna, çfarë profesione janë dhe çfarë shërbimesh të veçanta kryejnë ata njerëz, sepse sa unë jam në dijeni, prej vitit 2007 këtu ka njerëz të cilët vazhdimisht për këto vite punojnë dhe marrin rrogë me kontratë për shërbime të veçanta.

z.Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DPUMM), theksoi, në si Drejtori konform planit dinamik të hartuar në fillim të këtij viti, kemi proceduar në Departamentin e Prokurimit të gjitha kërkesat për të gjitha projektet e kësaj Drejtorie, me përjashtim të projekteve të cilat janë ridestinuuar-rialokuar për arsye të njohura tash më nga seancat e kaluara. Numri më i madh i projekteve ka qenë ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat e Komunës së Podujevës dhe në qytet. Gjendjen të cilën e keni para vetës është e vërtetë dhe reale, mirëpo ajo që vlen të ceket sot këtu është se pothuajse të gjitha projektet janë në fazën përmbyllëse dhe të realizimit të punimeve në terren. E kam thënë dhe po e përsëris se shpenzimi më i madhe që bëhet në ndonjë kontratë është çmimi i asfaltit. Ditëve të fundit duke përfshirë edhe dy ditët e vikendit ka projekte të cilat janë duke u realizuar të cilat në vazhdimësi i kam vëzhguar punimet dhe shpresoj që në afatin e paraparë kohorë konform planit dinamik të zhvillimit të punimeve, të gjitha ato projekte do të përfundojnë. Tani më disa rrugë janë asfaltuar, në qytet kemi dy kontrata me një kosto mjaft të lartë, mbi 700,000.00 € me mbi 11 kilometra gjatësi asfalt, ku mbi 60% apo rreth 4 kilometra të rrugëve të përfshira në ato dy kontrata janë të asfaltuara tash më, pastaj në fshatin Bajqinë-Lagja Kokorovic është përfunduar në tërësi projekti për asfaltim, mandej në fshatin Merdar janë dy akse të rrugëve prej të cilave njëri është përfunduar kurse tjetri është mbi 80% i përfunduar, pastaj në fshatin Livadicë disa lagje janë asfaltuar dhe ka përfunduar në tërësi projekti, gjithashtu kanë përfunduar projektet për asfaltim në fshatin Peran, asfaltimi i rrugës Batllavë-Dyz, po ashtu Lagja Kameri në fshatin Orllan, Lagjet Idrizi dhe Orzhanët, mandej kanë përfunduar asfaltimet edhe në fshatrat Shakovicë, Konushec etj, jemi në fazën përmbyllëse të realizimit të projekteve për asfaltim në fshatrat Zhiti dhe Barainë, sot ka filluar asfaltimi i rrugës "Ragip Hoti" në fshatin Bradash ndërsa janë edhe rrugët tjera në të cilat ka përfunduar faza e parë dhe vetëm pritet asfaltimi i tyre. Sa i përket përzgjedhjes së kompanive ose operatorëve ekonomik, shumë mirë e ceku drejtori parafolësi z.Faik Muçiçi se ajo çështje nuk është kompetencë e jona si drejtor të Drejtorive por është çështje e Prokurimit, mirëpo në bashkërisht me menaxherët e caktuar i monitorojmë kompanitë përkatëse sa i përket cilësisë gjatë zhvillimit të punimeve ose në përfundim të projekteve në përgjithësi, për çka ne mbajmë përgjegjësi.

z.Fatmir Gashi, drejtor i Drejtorisë së Administratës (DA), theksoi, sa i përket numrit të punëtorëve të angazhuar me kontratë për shërbime të veçanta, në një prej mbledhjeve të kaluara ju kam dhënë informatat përkatëse, mirëpo këshilltari z.Lutfi Rexhepi sërish parashtroi pyetje lidhur me këtë dhe unë po i përgjigjem, sa i përket Drejtorisë së Administratës, punëtorët në fjalë të cilët janë mëse të nevojshëm dhe të domosdoshëm, kryesisht janë me shkollë të mesme, por janë të angazhuar për shërbime teknike që ne kemi vlerësuar se janë të domosdoshme për arsye se janë rojtarë në objekte të ndryshme të Komunës duke përfshirë edhe atë në fshatin Orllan. Sa i përket personit që këshilltari i cekur po pretendon se është i punësuar me vite në këtë formë, fjala është për Ilmi Shabanin i cili që nga rregullimi i disa parqeve dhe hapësirave tjera, përkujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre.

z.Haki Rudari, theksoi, kolegu nga radhët e LVV-së natyrisht se në emër të Grupit i tha të gjitha rreth këtij raporti, por edhe unë dëshiroj të ndalem në disa projekte. Fillimisht dëshiroj ta ngrisë një çështje për të cilën u dhanë vërejtje në mbledhjen e KPF-së por që sot nuk u përmend nga askush këtu, ka të bëjë me mungesën e drejtorëve të Drejtorive të cilët janë sponsorues të pikave të caktuara të rendit të ditës, në mbledhjet e KPF-së, praktikë e cila mendoj se nuk duhet të

vazhdohet më tutje për arsye se nuk është në rregull të diskutohet për tema të rendit të ditës ku drejtorët përkatës nuk janë prezent në mbledhje. Unë personalisht kam përcjellë shumë mbledhje të KPF-ve në Komuna tjera të Kosovës ku gjithherë kanë raportuar për raporte të ndryshme periodike Kryetarët e Komunave, Nënkryetarët, e mos të flasim për drejtor të Drejtorive, prandaj kërkoj që në të ardhmen të jenë prezent në mbledhjet e KPF-së drejtorët e Drejtorive për arsye se kjo çështje është e rregulluar me ligj, sepse ne faktikisht diskutojmë për raporte përkatëse mirëpo kur drejtori përkatës mungon, nuk marrim përgjigjen e duhur.

Sa i përket raportit financiar, unë dua të ndalem fillimisht në raportin financiar të vitit 2014 ku në nëntëmujorin e parë kemi pasë investime në shumë 2,170,000.00 €, pastaj në vitin 2015 për periudhën e njëjtë kemi pasë investime në shumë 2,585,792.00 € ndërsa tani në vitin 2016 kemi rënie të investimeve, dhe kjo tregon atë që ne vazhdimisht e kemi përmend, mungesë të programit qeverisës nga Drejtoritë përkatëse, mungesë e seriozitetit, mungesë të përkushtimit apo ndoshta sot do të shtoj edhe një arsye tjetër, ndoshta frika nga zgjedhjet parlamentare apo lokale, e them këtë për arsye se nga asnjë drejtor nuk mund të arsyetohet fakti që të ketë investime kaq pak në investime kapitale ku nga 5,001,153.00 € të investohen në këtë nëntëmujor vetëm 1,549,480.00€ nuk është në rregull sepse nevojat e qytetarëve janë të shumta ku gjatë vizitave që hasim në terren dhe atyre që vijnë nëpër zyrat tona të LVV-së kërkesat e qytetarëve janë të shumta, dhe tani unë shtroj pyetje, si mund të ndodh të mbetet buxhet kurse nevojat e qytetarëve të mos merren parasysh. Kemi projekte të ndryshme për asfaltim të cilat i kanë sjellë qytetarët dhe të cilat ende nuk janë në zbatim, ndërkohë kemi buxhet për investime, pra nuk ka arsyetim këtu.

Çështje tjetër që unë dua të ndalem, është ngritja e kodeve, natyrisht që ju e thoni se kemi zbritje nëpër disa kode, por megjithatë kemi rritje të madhe në përqindje në disa kode, ku më duhet të ceku një rritje prej 54.7% për ujë, shtrohet pyetja a kemi kyçje të një numri të madhe të qytetarëve apo përse është kjo rritje, po ashtu rritje të madhe kemi edhe sa i përket shpenzimeve të telefonisë mobile gjë e cila u cek edhe nga parafolësit, pastaj furnizime për zyrë, furnizim me ushqim dhe pije, furnizime mjekësore, furnizim pastrimi etj, ku për të gjitha këto kode kemi rritje të shpenzimeve madje në shumë 631.63%, por në të njëjtë kohë nëpër shkolla kemi mungesë të këtyre mjeteve si, atyre higjienike, pastaj një rritje tjetër është 103.37% është tek kodi 14010 për mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve, duke pasur parasysh që ne kemi ndarë një buxhet dhe janë blerë automjetet e reja, mendoj që aq shpejt t'iu bëhet riparim atyre automjeteve nuk është në rregull. Dua të them diçka, një Laptop i imi ka pritur 7-8 muaj nëpër zyrë të Komunës dhe nuk është rregulluar për 70-80 euro, me arsyetim se mirëmbajtja dhe servisimi nuk nënkupton ndërrim të pjesëve, por megjithatë drejtori i DBF-së e bëri një zgjidhje dhe u rregullua ai Laptop, për çka e falënderoj, ndërsa për riparim dhe mirëmbajtje të automjeteve kemi me mijëra euro shpenzime. Rritje 83.82% po ashtu kemi tek regjistrimi i automjeteve por të njëjtën kohë kemi zvogëlim për sigurimin e automjeteve, gjë e cila është kontrast mes vete. Reklama dhe konkurse njëherë 1,400.00 € njëherë 1,300.00 € shifra këto vetëm sa për ta barazuar matematikën që në fund të vie baras. Objektet sportive 37,584.00 €, cilat janë ato objekte sportive, ne nuk mund të sillemi natë e ditë nëpër terren për të ditur se për cilat objekte bëhet fjalë, për këtë është Ekzekutivi i Komunës dhe janë zyrtarët, që t'i specifikojnë këto shpenzime, e jo vetëm të jepen shifra.

Për fund është edhe çështja tjetër që dua të ngrisë, në raportin financiar për vitin 2015 kanë figuruar shpenzime nëpër shkolla, ndërsa në këtë raport nuk figurojnë shpenzime nëpër shkolla, andaj pyes, përse ndodh kjo, gjë për të mendoj se pas kësaj fshihet diçka.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, dua të ndërlihem me drejtorin parafolës z.Faik Muqiçi, kam pyetje konkrete meqë janë mjete financiare dhe kalkulohen, 25,000.00 € që janë paguar kompanisë "Bini", ne absolut nuk jemi kundër pse ajo kompani ka kryer punë, mirëpo nëse e kalkulojmë

çmimin e tregut të zhavorrit me pakicë përkatësisht me një kubik, i bie që kompania "Bini" është dashtë të hedh afro 2000 kubik zhavorr në varrezat e fshatrave Tërnavë dhe Dobratin, unë i them drejtorit në fjalë se nuk janë hedh 2000 kubik zhavorr në ato rrugë të varrezave, madje nuk janë hedh as 1000 por as 500 kubik zhavorr në rrugët e varrezave të fshatrave të cekura, kurse janë bërë pagesa në shumë 25,000.00 €. Pra drejtori i DSHPMSh e tha se janë shtruar me zhavorr rrugët e varrezave në fshatrat Tërnavë dhe Dobratin, ndërsa mund ta kalkuloni, 17 euro është një kubik zhavorr po që se merret në vend, 8 euro është te gurëthyesit me shumicë ose 12 euro zhavorri i ricikluar, mirëpo unë e llogarita çmimin maksimum të pakicës 17 euro një kubik, e që kompania në fjalë është dashtë të hedh 2000 kubik zhavorr, unë konsideroj se jo dhe mendoj se edhe drejtori e dinë që jo nuk janë shtruar rrugë me 2000 kubik zhavorr, kurse pse janë bartur mjetet buxhetore në konton e asaj kompanie është çështje tjetër dhe kjo do të sqarohet.

Unë mendoj se edhe Kuvendi i Komunës duhet ta ngritë një Komision i cili do të mbikëqyrte atë punë, e jo grupe të këshilltarëve të Kuvendit të cilat për interesa programore bëjnë politikë këtu, mirëpo nuk ka nevojë të paguhen 2000 kubik zhavorr nëse janë hedh 300 kubik, madje ndoshta as 300 jo. Po ashtu mendoj se për Komunën e Podujevës 25,000.00 € janë shumë e madhe e mjeteve që të paguhen një kompanie për qejfin e dikujt, por kërkoj të ngritët një komision i cili do të vizitonte rrugët e varrezave të fshatrave Tërnavë dhe Dobratin dhe të konstatonte për afërsisht sa kubik zhavorr janë hedh në ato rrugë në mënyrë që të sqarohet pagesa e cekur.

Për rrugët Battlavë-Dyzë, Orllan-Keqekollë dhe për rrugën e fshatit Surdull ne disa herë kemi biseduar në këtë Kuvend ku edhe na është thënë se janë projekte të nivelit qendror andaj për këtë arsye janë ridestinuuar edhe mjetet e parapara për ato projekte nga ana e Komunës, ndërsa sipas këtij raporti del se janë paguar mjete buxhetore për rrugën e asfaltuar Battlavë-Dyzë, dhe për këtë pyes drejtorin e DPUMM z.Durim Salihu, ai projekt a do të paguhet nga Ministria e Infrastrukturës apo nga Komuna e Podujevës. Gjithashtu kam edhe një pyetje tjetër që ndërlidhet me shëndetësinë, në ambulancat e fshatrave Bradash dhe Orllan si dhe në QKMF-Podujevë në vitin 2016 janë angazhuar punëtorë për shërbime të veçanta, për çfarë shërbimesh të veçanta bëhet fjalë, për roje të objekteve, për mirëmbajtje të parqeve apo shërbime të veçanta specialistike në fushën e shëndetësisë. Edhe pse drejtori përkatës vetë i ka angazhua ata punëtorë, unë si qytetarë i Podujevës kërkoj që atyre punëtorëve t'iu bëhen kontratat e rregullta dhe mos të mbahen nën presion.

z.Faik Muqiçi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, lidhur me atë që parafolësi e ceku, ne mund të flasim për secilin projekt veç e veç dhe me dëshirë e ftoj parafolësin në zyrë në mënyrë që t'ia tregoj gjithë dosjen e punimeve në infrastrukturën e varrezave. Nuk bënë të keqpërdoret një situacion në shumë 7,000.00 € dhe se nuk ka të bëjë vetëm me dy fshatra që parafolësi i përmendi, mirëpo në kuadër të rregullimit të varrezave janë së paku 11 rrugë të cilat janë shtruar me zhavorr, pastaj për secilën rrugë veç veç është sasia dhe gjatësia e shtruar me zhavorr për të cilat është bërë pranimit teknik, prandaj të mos keqkuptohet kjo çështje sepse ky nuk është projekt i vetëm dy rrugëve por është i disa rrugëve në fshatra të ndryshme si; Dobratin, Tërnavë, Lepajë, rruga te Vrella e Revuçit, Dumnicë, Sallabajë, pastaj disa rrugët të varrezave në Qytet e të tjera, pra e përsërisë se nuk është projekt vetëm i dy rrugëve por mund të shikohet komplet dosja e punimeve dhe të vërtetohet kjo që unë e them. Është opinion i keq kur thuhet se është vetëm një ose dy rrugë kurse janë 2000 kubik zhavorr. Për hir të transparencës jam i gatshëm t'jua jap secilit prej juve apo t'i publikoj të gjitha dosjet e punimeve të shtrimit të rrugëve me zhavorr.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, i them drejtorit parafolës, sot miratohet raporti financiar për periudhën janar-shtator 2016, dhe pas miratimit ne nuk kemi çka të kërkojmë pastaj në zyre për të shikuar dhe analizuar dokumentacionin e këtij projekti, e them këtë sepse sot miratohet raporti në fjalë dhe sot ka rastin të arsyetohet Ekzekutivi i Komunës për shpenzimet e bëra, mirëpo ju drejtor mund të shkoni në zyrë, ta merrni dokumentacionin përkatës dhe ta jepni arsyetimin e kërkuar, ngase unë nuk kam pse të shikoj dokumentacion kur para vetës e kam raportin financiar në të cilin figuron shuma 25,000.00 € e paguar për infrastrukturë të varrezave.

z.Flakron Gashi, theksoi, u tha më herët se ky raport pasqyron të hyrat dhe të dalat e rregullta të Komunës, por të gjithë ata që e potencojnë kështu duhet ta kenë të qartë se ky raport është obligim ligjor dhe nuk mund të deklaroj të hyra dhe të dala të rrejshme. Për ata parafolës të cilët e potencuan se ky raport financiar nuk pasqyron dinamikën e rregullt të punës që është duke u bërë, megjithatë është edhe pak më ndryshe. Nëse për periudhën nëntëmujore në investimet kapitale kanë arritur të ekzekutohen pagesa në vlerë 1,549,000.00 € apo 30% e vlerës së paraparë për këtë kategori, tregon se deri në muajin e nëntë janë kryer vetëm 30% e projekteve të parapara, dhe shtrohet pyetja, a ka kapacitet Komuna e Podujevës që për këtë tremujorë të mbetur të vitit të inspektoj dhe të kontrolloj në detaje projektet të cilat është dashur të kryhen më herët, kurse 70% e këtyre projekteve mbesin për tu kryer në tremujorin e fundit të vitit. Nuk ka mëdyshje se Komuna e Podujevës afër 4 milion euro ose rreth 80% të buxhetit të investimeve kapitale e orienton në vetëm dy fusha, në urbanizëm dhe në shërbime publike, dhe nëse në këto dy fusha del se ka kompani që fiton 18 herë tender brenda nëntë muajve, e që e njëjta mund të fitoj edhe 10 ose 18 herë brenda këtij viti, shuma prej 4 milion eurove, kryesisht 50% e kësaj fushe thithet nga 4-5 kompani për të cilat edhe kur të shpallet tenderi predispozitat janë të caktuara sepse dihet kush do t'i fitoj. Nevojat e qytetarëve të Komunës së Podujevës nuk janë vetëm në urbanizëm dhe në shërbime publike, mirëpo kjo tregon se interesa të caktuara qëndrojnë mbrapa kësaj. Çështja tjetër, Kjo Komunë, me buxhetin dhe rialokimet që i bënë tregon qartë ku e ka kategorizuar rininë, kulturën dhe sportin si dhe ku e ka kategorizuar zhvillimin ekonomik lokal me shuma nga 200,000.00 € buxhet, predispozitat janë që secili drejtor që vie në këto dy fusha të jenë të dështuar, mirëpo këto dështime nuk janë të drejtorëve por janë të z.Veliut, dhe ai duhet të ndërmarr masa që këto çështje të përmirësohen.

z.Hasan Softolli, theksoi, raporti financiar nëntëmujor për vitin 2016 është i hartuar në mënyrë të detajuar për secilin pozicion dhe për këtë është për tu lavdëruar Drejtorja e Buxhetit dhe Financave sepse të gjitha raportet financiare periodike dhe vjetore i procedon me kohë në Kuvendin e Komunës. Po ashtu shpalosjet financiare janë të plota dhe që neve na mundësojnë t'i shohim në mënyrë kronologjike ngjarjet dhe aktivitetet që ndodhin në Komunën e Podujevës. Normalisht që informacionet na tregojnë që dinamika e shpenzimit të buxhetit deri në këtë periudhë është paksa e ngadalshme veçmas në investime kapitale dhe në subvencione, gjë për të cilën sigurisht se Ekzekutivi i Komunës e ka parasysh këtë dhe shpresojmë që deri në fund të vitit kjo çështje të jetë e përmbyllur, e them këtë për arsye se drejtorët e disa Drejtorive treguan arsyet e tyre rreth disa punëve të cilat kanë filluar më herët dhe të cilat nuk kanë mundur të përfshihen në këtë raport nëntëmujor. Po ashtu pozitive në këtë raport është edhe përqindja e realizimit të të hyrave vetanake që mendoj se është shumë e kënaqshme e cila në disa kategori edhe ka tejkalime dhe shpresojmë që deri në fund të vitit të arrihet shuma e planifikuar e inkasimit të të hyrave vetanake. Sa i përket pozicioneve të shpenzimeve deri në këtë periudhë raportuese shihet se disa pozicione janë më të ulëta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, por në disa pozicione normalisht dhe me arsye ka ngritje. Konsideroj se Ekzekutivi i Komunës në mënyrë

të vazhdueshme ka pasur kujdes në shpenzime të pa nevojshme, ne inkurajojmë Ekzekutivin për shfrytëzimin e buxhetit në mënyrë maksimale dhe atë në ato prioritete që ka përcaktuar.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, fillimisht falënderoj të gjithë parafolësit për kontributin e dhënë sa i përket këtij raporti financiar si një dokument shumë i rëndësishëm për Kuvendin e Komunës së Podujevës. Singërisht e them se unë prita që ndokush nga ju këshilltarët e Kuvendit, së paku ata që janë punëtorë në shëndetësi, të përmendni një fakt të rëndësishëm për Komunën e Podujevës, Vendimin për themelimin e spitalit të përgjithshëm të nivelit dytësor shëndetësorë në Komunën e Podujevës, dhe me këtë rast përgëzoj të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës për këtë ngjarje të rëndësishme.

Nga diskutues të ndryshëm u tha, qoftë në mënyrë hipotetike apo vetëm sa për të thënë ashtu, që Komuna e Podujevës është Komuna më e varfër në Kosovë, nuk di se në bazë të cilave statistika thuhet një gjë e tillë, ndërsa është mirë që kur të jepen konstatime të tilla, të merren për bazë statistikat ose të thirreni në statistika zyrtare, shembull, Komuna e Podujevës në raport me NN Komunën ka këtë zhvillim, ka këtë papunësi etj, e jo vetëm të jepen konstatime, sepse duhet ta keni parasysh se kjo është fjalë publike. Gjithashtu u tentua të hidhet një tezë kinse qeverisja lokale nuk ka shpenzuar buxhetin duke shpresuar në zgjedhje të jashtëzakonshme, për këtë jeni në dijeni se qëndrimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës është që zgjedhjet mbahen në afatin e paraparë me ligj, andaj lidhur me këtë nuk ka hamendje se gjoja ne si Ekzekutiv i Komunës nuk kemi shpenzuar buxhetin sepse kemi pritur që një parti e caktuar politike të imponoj zgjedhje të jashtëzakonshme në nivel lokal apo në nivel shtetëror. Po ashtu u cek pyetja, se çfarë bëhet me të hyrat vetanake në dy kategori, arsim dhe shëndetësi, mirëpo u harrua fakti se të hyrat në kategorinë e arsimit që bëhen nga pagesat e frekuentuesve të arsimit jo formal është obligim ligjor ku 70% e atyre të hyrave iu kthehen mësime dhënëse të cilët mbajnë mësim shtesë në nivel të arsimit për të rritur ndërsa 30% e tyre të hyrave destinohen për mallra dhe shërbime, e njëjta gjë ndodh edhe në shëndetësi ku të hyrat vetanake në këtë kategori të cilat destinohen për paga nuk janë të hyra që realizohen nga Komuna, por janë të hyra të cilat realizohen nga Drejtoria përkatëse, sikurse që ndodh edhe për Drejtorinë e Arsimit, pra shpenzimi i tyre rregullohet me ligj. U përmend edhe çështja e operatorëve ekonomik, çështje për të cilën unë mund t'ju them se ndoshta jemi prej komunave të vetme në Kosovë që në vitet e fundit nuk kemi pasë asnjë kontratë të zhvlerësuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit ose nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, gjë e cila mund të vërehet në vazhdimësi viteve të fundit edhe në raportet e Auditorit të Përgjithshëm, prandaj kur thuhet diçka është mirë të argumentohet me fakte, e jo vetëm të thuhet.

z.Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, theksoi, sa i pyetjes së shtruar nga z.Rafet Llapashtica rreth mjeteve të paguara për projektin, asfaltimi i rrugës Batllav-Dyz, ju njoftoj se ai projekt ka qenë në bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës e cila ka participuar me mjete buxhetore në shumë mbi 22,000.00 €, kurse Komuna 90,000.00 €.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, konsideroj se në rastet kur drejtorët e Drejtorive nuk po kanë përgjigje, po detyrohet Kryetari ose Nënkryetari i Komunës të marrin fjalën dhe të japin përgjigje. Unë e dëgjova diskutimin e këshilltarit z.Hasan Softolli i cili foli më shumë si drejtor se sa si këshilltarë i Kuvendit, ndërsa për rolin e një këshilltari besoj se jemi në dijeni të gjithë, mirëpo për këshilltarin e LDK-së në fjalë, kam pyetje, dhe atë a keni dal të inspektoni ndonjë punë e cila është kryer nga Ekzekutivi i Komunës në ndonjë lokalitet dhe të shikoni dhe analizoni pagesat e raportuar në këtë raport financiar se a janë ashtu apo jo, si dhe a jeni në dijeni se kujt i janë paguar dhe për cilat Drejtori 7,000.00 € shpenzime për telefoni mobile, shumë të cilën sot ky Kuvend sigurisht se do ta legjitimoj, mirëpo unë besoj se z.Softolli nuk është në dijeni për këto, nëse po të na sqaron këtë.

z.Hasan Softolli, përgjigje parafolësit, theksoi, unë nuk shkoj në asnjë lokacion të bëjë inspektime as kontrole sepse nuk jam as hetues dhe nuk kam as kompetencë për një gjë të tillë, sa i përket shpenzimeve të telefonisë, këshilltari parafolës është punëtor i Postës dhe Telekomit të Kosovës dhe sigurisht është në dijeni edhe për shpenzimet e komunave tjera sa i përket kësaj fushe dhe mund të bënë edhe krahasime të tilla.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, unë nuk jam i zgjedhur të shikoj shpenzimet e komunave tjera, por jam i zgjedhur të shikoj dhe analizoj shpenzimet e Komunës ku kam marrë votat. Sa i përket pyetjes time konkrete rreth shpenzimeve të telefonisë mobile, unë nuk mora përgjigje.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, nuk është e ndershme nga këshilltari parafolës që t'i parashtron pyetje të tilla një këshilltari të LDK-së në lidhje me vendin dhe shumën e shpenzuar të mjeteve buxhetore, e them këtë për shkak se ato mjete nuk janë shpenzuar nga këshilltari në fjalë por i njëjti vetëm ka shikuar raportin financiar dhe materialin e shpenzimeve të Komunës për këtë nëntëmujorë. Andaj nuk është e drejtë t'i drejtoheni një këshilltari të Kuvendit me pyetjen, a e din ti, ngase anëtarët e Kuvendit nuk i bëjnë shpenzimet për të cilat u ngrit debati përkatës, por janë drejtorët e Drejtorive përkatëse n'kuadër të të cilave janë bërë shpenzimet. Pra edhe një herë e përsërisë se nuk më duket e arsyeshme t'i drejtoheni në atë formë një këshilltari të Kuvendit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ne jemi kolegë njëri me tjetrin dhe të jeni të bindur se nuk e luajmë rolin e një grupimi të ngushtë politik, cili do subjekt qoftë, mirëpo këto janë projekte të mëdha që përfaqësojnë grupime me rreth 20 mijë njerëz. Nuk është problemi që janë shpenzuar ajo shumë e mjeteve, mirëpo disa prej këshilltarëve sot do t'i legjitimojnë ato shpenzime me një ngritje të dorës, ku një ndër ata është edhe zotëri Softolli.

z.Bahri Selimi, theksoi, fillimisht shprehi keqardhje për Kryesuesin e Kuvendit të cilit mendoj se i ka dal prej dore kjo seancë sepse unë ka rreth një orë që kam kërkuar fjalën kurse pati këshilltarë tjerë të cilët 4-5 herë morën fjalën. Kërkova fjalën rreth një pyetje të mëhershme që e parashtrova dhe për të cilën drejtori përkatës nuk më dha përgjigje, mirëpo atë përgjigje e tha Nënkrjetari i Komunës, fjala është për pagesat e bëra nga të hyrat vetanake në arsim dhe shëndetësi, për të cilat Nënkrjetari i Komunës e ceku se në bazë të ligjit, 70% e të hyrave iu kthehen punëtorëve të arsimit respektivisht atyre të shëndetësisë për shkak se ato të hyra inkasohen nga vetë ato dy sektorë, por nuk u përmend se për cilin ligj bëhet fjalë, andaj pyes, për cilin ligj bëhet fjalë dhe cili është ai ligj i cili e përcakton atë formë. Unë vetëm po e lexoj nenin 11 të ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, ku flitet për limitet dhe zotimet dhe thuhet, asnjë organizatë buxhetore nuk mund të tejkaloj numrin e pozitave të punësimit në nivel të programit për Komunitat dhe nën-programit për nivel qendrorë. Sa i përket Vendimit për themelimin e spitalit të përgjithshëm që Nënkrjetari i Komunës e ceku, mendoj se është një vendim i mirë dhe për çdo punë të mirë që bëhet ne i gëzohemi dhe kjo besoj se është e mirëseardhur për të gjithë qytetarët, mirëpo ky Vendim nuk është edhe që duhet t'i gëzohemi aq shumë tash për momentin por këtij Vendimi është dashtë t'i gëzohemi tash e një viti kur edhe Kryetari i Komunës është zotuar se këtë çështje do të hapë para një viti, por megjithatë nuk është vonë edhe tani.

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, edhe pse Nënkrjetari i Komunës teorikisht shumë mirë e sqaroi çështjen rreth shpenzimit të hyrave nga shëndetësia dhe arsimit, edhe unë dëshiroj të sqaroj këtë pozicion, është vetëm një pagesë prej të hyrave vetanake për paga dhe mëditje në shëndetësi dhe arsim në shumë 21,873.50 €, ndërsa pjesa tjetër në shumë 10,169.68 € është pagesë që bëhet nga Komisioni Evropian për projektin e Qendrës për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve në fshatin Sfeqël, konkretisht për pagat e tre zyrtarëve të cilët punojnë në atë projekt. Në shëndetësi, nga të hyrat vetanake që krijohen nga participimi i qytetarëve paguhen kujdestaritë, ndërsa në arsim ashtu siç e ceku edhe

Nënkryetari, pagesat bëhen nga bashkëfinancimi për mësim për të rritur ku pjesa e caktuar e mjeteve iu paguhet mësimdhënësve përkatës, pra nuk janë pagesa të cilat bëhen nga granti por nga të hyrat e cekura. Prandaj këto dy shuma figurojnë në raportin financiar ku edhe janë të sqaruara se nga e kanë burimin financiar, pagesa e parë nga të hyrat vetanake kurse pagesa e dytë nga Komisioni Evropian.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj të gjithë parafolësit për diskutimet e tyre lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Edhe pse me ligj nuk është e paraparë që raportet financiare periodike t'iu nënshtrohen procedurave të votimit, Kuvendi i Komunës së Podujevës ka vite që e praktikon që për raporte të tilla të hedhën në votim, andaj e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se me 18 vota për, 13 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua raporti financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – shtator 2016.

3. Propozimi Rregullores për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Komunën e Podujevës

- Propozimi i Vendimit për vënie në diskutim publik

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar për këtë pikë të rendit të ditës dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim me disa rekomandime të cilat mund t'i gjeni në konstatimet e marra në hyrje të kësaj mbledhjeje. Drejtoresha e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit në mbledhjen e KPF-së nuk ka mund të marrë pjesë në mbledhje, mirëpo tani është prezentë në këtë mbledhje e cila do të arsyetoj propozim dokumentet përkatëse si dhe mund të propozoj kohën e diskutimit publik dhe datën e debatit publik me qytetarë.

znj.Mrika Thaqi, drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit (DKRS), e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, para vetës keni dy propozim dokumente të cilat rregullojnë dy prej institucioneve shumë të rëndësishme në fushën e kulturës dhe rinisë, përkatësisht propozim Rregulloren për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Komunën e Podujevës, dokument sipas të cilit zyrtarizohet konsolidimi i Organizatave Rinore Lokale në një trupë të vetme siç është Këshilli i Veprimit Rinorë Lokal – KVRL, ashtu siç parashihet me Ligjin 03/L-145 për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë.

Gjithashtu kemi edhe pikën e radhës të rendit të ditës që është propozim Statuti i Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë, Teatër i cili në bazë të legjislacionit përkatës është themeluar nga ky Kuvend dhe i cili mban emrin e artistit të ndjerë Avdush Hasanit pran veprës të të cilit edhe fjala më e madhe humb madhështinë e saj, andaj jo vetëm që e kemi obligim por vetë ky emër na obligon për nivelin e punës që duhet të mbajmë. Prandaj Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit duke u zotuar për përkrahje të vazhdueshme operative dhe që diskutimi publik përfshirë edhe debatet publike për këto dy dokumente do të jenë gjithëpërfshirëse, transparente dhe përmbajtjesore ju ftoj që të miratoni dy propozim vendimet e cekura në pikën 3 dhe 4 të rendit të ditës, për vënie në diskutim publik të këtyre dy dokumenteve në mënyrë që të dëgjohet edhe zëri i qytetarëve, dhe njëkohësisht ju ftoj të jeni pjesë aktive e debateve përkatëse.

Sa i përket diskutimeve dhe debateve publike, fillimisht pajtohem me rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa që diskutimi publik për propozim Rregulloren për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Komunën e Podujevës të jetë 30 ditë, nga

01.11.2016 deri më 30.11.2016, ndërsa debati me qytetarë të mbahet më 23.11.2016 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës duke filluar në orën 10;00, ndërsa për propozim Statutin e Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë, propozoj që diskutimi publik të zgjat 30 ditë, nga 01.11.2016 deri më 30.11.2016, kurse debati publik me qytetarë të mbahet më 21.11.2016, në orën 10;00 në sallë e mbledhjeve të Kuvendit.

Për fund, ju drejtohem dy këshilltarëve të Kuvendit të cilët janë edhe anëtarë të KPF-së, ndjejë keqardhje që për shkaqe personale nuk kam mundur të jem prezent në mbledhjen e KPF-së, mirëpo konsideroj se as për problemet e rinisë dhe funksionimit ditor të OJQ-ve lokale, dhe as për çështjen e Teatrit, nuk jeni në dijeni më shumë se qytetarët e Komunës së Podujevës, vërejtjet, propozimet dhe sugjerimet e të cilëve do t'i marrim gjatë diskutimit dhe debateve publike për dy dokumentet në fjalë.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se parafolësja drejtoresh e DKRS-së e paraqiti fjalën hyrëse dhe arsyetoi dy propozim dokumentet sipas pikave 3 dhe 4 të rendit të ditës, të cilat vihen në diskutim publik ku do të kenë mundësi të gjithë të japin vërejtje, propozime dhe sugjerime të ndryshme, pastaj në bazë të procedurave përkatëse këto dy propozime sërish do të jenë pika të rendit të ditës në një mbledhje të radhës ku në bazë të raporteve nga debatet publike do të miratohen si akte finale të këtij Kuvendi.

z.Mirsad Kamerolli, theksoi, e përgëzoi parafolësen drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit për fillimin e punës së saj, konsideroj se emërimi i saj në këtë pozitë është emërimi më i mirë që ka mund të bëhet në detyrën përkatëse dhe njëkohësisht besoj se ky është vetëm fillimi i suksesit të punës së saj në DKRS.

z.Fidan Rekalju, theksoi, në Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim propozim Rregulloren për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Komunën e Podujevës, ose më mirë të them, ri funksionalizimin e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal për shkak se sa unë kam informata KVRL në Podujevë është funksionale, mirëpo kërkohet që ne si Kuvend i Komunës t'ia japin legjitimitetin e duhur.

Meqë drejtoresha e DKRS-së në fjalën hyrëse përmendi dhe arsyetoi dy pikat e rendit të ditës përkatësisht edhe pikën e radhës, propozim Statutin e Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë, pika të cilat janë të ndara veç e veç, por si do që të jetë aktualisht jemi në pikën 3 dhe ne si Grup e përkrahim propozim Vendimin për vënie në diskutim publik të propozim Rregullores procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Komunën e Podujevës, ndërsa për propozimi e radhës pikën 4, natyrisht që e përkrahim mirëpo këtë e deklarojmë sa të vie radha e diskutimit për pikën e radhët të rendit të ditës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në mbledhjen e KPF-së jemi dakorduar ashtu siç edhe mund t'i gjeni në konstatimet e KPF-së. Edhe Grupi i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës e ka mbështetur dhe e mbështetë themelimin e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal, për të cilin mendoj se është dashur të zyrtarizohet më parë, mirëpo sa unë kam lexuar në lidhje me këtë Këshill, funksionimi i tij do të jetë si një OJQ për të cilën parashihen edhe ndarje të mjeteve buxhetore dhe raportime financiare nga ana e këshillit. Po ashtu në Komunën e Podujevës kemi edhe OJQ tjera të cilat sigurisht se do t'i orientohen DKRS-së për mbështetje financiare siç është rasti i OJQ-së Handikos të cilën vazhdimisht ne si Kuvend e kemi mbështetë me një buxhet të limituar që ndoshta është i vogël për atë kategori. Ne sot për këtë dokument nuk marrim vendim përfundimtar por vetëm votojmë për vënie në diskutim publik dhe mbajtje të debatit publik ku pastaj sigurisht se propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet e qytetarëve do të merren parasysh dhe do të inkorporohen në dokumentin final i cili sërish do të sjellët në Kuvend për miratim final ku edhe ne këshilltarët e Kuvendit do të kem mundësi të debatojmë më gjerësisht

rreth këtij propozimi, mirëpo kërkoj nga Drejtoresha e DKRS-së që ky Këshill të mos jetë politik i asnjë subjekti por të jetë Këshill i të rinjve të Podujevës në mënyrë që zgjedhjet e strukturave të Këshillit të bëhet nga vetë rinia, nuk po paragjykoj asnjë subjekt politik, mirëpo nëse mendojmë t'i kontribuojmë këtij procesi, lusë drejtoreshën që të jap kontributin e saj ndaj dokumentit përkatës për të cilin besoj se të gjitha subjektet do ta mbështesin me qëllim të ecjes përpara të interesave të rinisë ku edhe ne si Kuvend sigurisht se do të ndajmë buxhet për këtë OJQ, pra e përsërisë kërkesën që mos të ketë interferime politike në këtë aspekt, dhe që dokumenti final të jetë i kompletuar mirë.

Meqë drejtoresha e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit në fjalën hyrëse i dha arsyetimet edhe për propozim Statutin e Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë që është pikë e radhës e rendit të ditës, ne si Kuvend kemi marrë vendim për themelimin e Teatrit dhe sigurisht se edhe për çështjet tjera sa i përket Teatrit do i mbështesim sikurse që është vënia në diskutim publik dhe mbajtja e debatit publik për këtë çështje sepse janë procedura ligjore të cilat nuk mund të kontestohen nga asnjë subjekt politik, prandaj edhe ne si Grup nga radhët e PDK-së i kemi mbështet dhe i mbështesim çështjet që ndërlidhen me Teatrin.

z.Haki Rudari, theksoi, natyrisht se në mbledhjen e KPF-së e kemi diskutuar këtë propozim, mirëpo ka munguar drejtoresha e DKRS-së e që tani mundohet fajin e vet t'ia hedh tjetër kujt.

Neni 5 i propozim vendimit për vënie në diskutim publik të propozim Rregullores përkatëse, thotë *diskutimin publik e zbaton Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit e cila është e obliguar që për Kuvend të përgatit raportin për zbatimin e diskutimit publik mbi bazën e propozimeve, vërejtjeve e të tjera*, prandaj po e përsërisë edhe njëherë që nuk është mirë që sponzoruesit e një pike të rendit të ditës të mos jenë fare prezent në një mbledhje përkatëse, Kryesuesi i Kuvendit nuk ka pasur kurrfarë informatash për mungesën e drejtoreshës së cekur në mbledhjen e KPF-së sikur se që nuk kemi pasur as ne anëtarët e KPF-së, e që mendoj se është dashur të njoftohemi për arsyet. Çështja tjetër që dua ta përsërisë është se duhet ta largojmë politikën nga organizatat rinore. Lëvizja Vetëvendosje e përkrah në parim këtë propozim Rregullore dhe do të jep kontributin e vet brenda këtyre 30 ditëve ku do të takohemi me organizata të ndryshme rinore, por megjithatë nuk jemi që këto organizata të jenë marionetë e partive politike ose partisë në pushtet dhe nuk do ta përkrahim një gjë të tillë, por do të përkrahim organizata të cilat janë pa ndikime politike, që kanë statutin e tyre dhe pavarësinë e tyre në aktivitete dhe veprimtari të tyre, në të kundërtën do ta kundërshtojmë fuqishëm, dhe këtë do ta bëjmë edhe në debatin publik për ato organizata rinore të cilat janë në ndikim të partisë në pushtet.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për diskutim, mirëpo për këtë dokument do të kemi rastin të debatojmë sërish pas diskutimit publik dhe debatit publik me qytetarë i cili është propozuar të mbahet më 23.11.2016, unë e hedh në votim propozim vendimin përkatës duke përfshirë edhe konstatimin përkatës të rekomanduar nga mbledhja e KPF-së.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozim vendimi për vënie në diskutim publik të propozim Rregullores për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimtari Rinor Lokal në Komunën e Podujevës, duke përfshirë edhe rekomandimin nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 28 tetor 2016.

4. Propozimi i Statutit të Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë

- Propozimi i Vendimit për vënie në diskutim publik

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, drejtoresha e Drejtorisë së Kulturës Rinis dhe Sportit, në fjalën hyrëse të pikës paraprake të rendit të ditës i bëri sqarimet dhe arsyetimet e nevojshme edhe për këtë pikë të rendit të ditës duke përfshirë edhe propozimin për kohën e diskutimit publik dhe datën e mbajtjes së debatit publik me qytetarë që ishte 21.11.2016 duke filluar nga ora 10;00, andaj meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për diskutim, e hedh në votim propozim vendimin për vënie në diskutim publik të propozim Statutit të Teatrit.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozim vendimi për vënie në diskutim publik të propozim Statutit të Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë, me konstatim që diskutimi publik të zgjatë 30 ditë, nga 01.11.2016 deri më 30.11.2016, kurse debati publik me qytetarë të mbahet më 21.11.2016 duke filluar nga ora 10;00.

5. Të Ndryshme

znj.Adelinë Stublla, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, kërkojmë që në seancën e radhës si pikë e rendit të ditës të jetë raporti i punës nga Drejtoria e Inspeksionit.

Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të mbyllur, meqë nuk pati këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën.

Mbledhja përfundoi në orën 11;40

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-80654
Podujevë,
31 tetor 2016**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**